



Prishtinë, 24 qershor 2010  
Kodi i ZRRE-së: V\_255\_2010

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke marrë parasysh:**

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Nenit 15 paragrafi 2 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Ligji Nr. 2004/9 të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Kërkesën për derogim të kapitullit të 7 të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, të bërë me datë 07.05.2010 nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A),

**në seancën e mbajtur më 24 qershor 2010 nxori këtë:**

**VENDIM**

**I. I REFUZOHET** - derogimi i kapitullit të 7 të Rregullës për shkyçje dhe rikycje të konsumatorëve në sektorin e energjisë.

**Arsyetim**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 07.05.2010 ka pranuar kërkesën e të licencuarit-Korporatës Energjetike të Kosovës(KEK SH.A.) për derogimin e Kapitullit të 7 të Rregullës për shkyçje dhe rikycje të konsumatorëve në sektorin e energjisë.
2. Pas shqyrtimit të kërkesës së KEK SH.A për derogim të Kapitullit të 7 të Rregullës për shkyçje dhe rikycje, Bordi i ZRRE-së, ka vendosur që të refuzojë, për arsye si më poshtë:
  - Rregulla për shkyçje dhe rikycje të konsumatorëve në sektorin e energjisë e aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 24 shkurt 2006 i ka dhënë të drejtë KEK SH.A për realizimin e zbatueshmërisë së shkyçjeve grupore në periudhë prej 18 muaj, nga data e miratimit të Rregullës. ZRRE derisa kanë qenë në fuçi dispozitat e lejimit të shkyçjeve grupore asnjëherë nuk ka pranuar nga KEK-u një kërkesë ku kërkohet shkyçja grupore.
  - Rregulla për shkyçje dhe rikycje të konsumatorëve në sektorin e energjisë e aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, me datë 27 maj 2009, i ka dhënë të drejtë KEK SH.A për realizimin e zbatueshmërisë së shkyçjeve grupore në periudhë prej 6 muaj, nga data e miratimit të Rregullës. ZRRE derisa kanë qenë në fuçi dispozitat e lejimit të shkyçjeve grupore asnjëherë nuk ka pranuar nga KEK-u një kërkesë ku kërkohet shkyçja grupore.

- Rregulla për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë i mundëson KEK SH.A që të zbatoj shkyçje individuale për mos pagesë të energjisë elektrike në përputhje të plotë me Rregullën.
- II. Të gjitha dispozitat e Kapitullit të 7 të Rregullës për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë mbesin në fuqi.
  - III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
  - IV. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Përparim Kabashi, Anëtar

---

Blerim Koci, Anëtar